

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim pastrimi i ambjenteve të brendshme dhe të jashtme, për nevoja të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) 90910000-9.

VLERA E FONDIT LIMIT: 135,391,381.34 (njëqind e tridhjetë e pesë milion e treqind e nëntëdhjetë e njëmijë e treqind e tetëdhjetë e një pikë tridhjetë e katër) lekë pa tvsh ose 1,349,595.11 (një milion e treqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë njëmbëdhjetë) Euro pa TVSH.

*(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (100.32), datë 17.07.2024, ora: 12:29)*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në Shtojcën 8, pika 1 të DST.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 8 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektivit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomikë kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit, sipas objektit të prokurimit, Kodi III.1.A.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke siguruar kështu AK që shërbimi do të kryhet nga operatorë të cilët disponojnë kapacitetet profesionale për kryerjen e këtij shërbimi, brenda standarteve.

Referuar nenit 29, pika 1, të Ligjit nr. 10 431, date 9.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”, si dhe duke marrë në konsideratë që shërbimi i pastrimit të ambjenteve të brendshme e të jashtme të spitalit, është një shërbim gjatë kryerjes të së cilit kërkohet përdorimi i produkteve që përmbajnë kimikate, përdorimi i produkteve që mund të çojnë në lëshimin e ndotësve të ajrit të brendshëm, të cilat mund të jenë të dëmshme për shëndetin e pacientëve dhe stafit, përdorimi i makinerive të pastrimit, të cilat kontribuojnë në emetimin e gazrave të dëmshëm, vlerësohet se ky shërbim ka ndikim në ndotjen në mjedis.

Lloji dhe kategoria e lejes së mjedisit të kërkuar, mbështetet në nenin 29, pika 3, e Ligjit nr. 10 431, date 9.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, Shtojcën 1, gërma f, Pastrues të tjerë sipërfaqesh, Veprimtaria në pikën të 7.12 “Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve”, të Ligjit Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar , VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

S SH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit.

Duke marrë në konsideratë faktin se standarti S SH EN ISO 14001:2015 specifikon kërkesat për sistemin e menaxhimit të mjedisit për t’i krijuar mundësinë një organizate të zhvillohet dhe të implementojë (ose zbatojë) një politikë dhe objektiva të cilat marrin parasysh kërkesat ligjore dhe kërkesa të tjera në lidhje me aspekte të rëndësishme mjedisore, vlerësohet se plotësimi i këtij standarti lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri që shërbimi i pastrimit do të kryhet konform standarteve të kërkuara, për mbrojtjen e mjedisit ku do të kryhet ky shërbim, mbrojtje e cila ndihmon në parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të pacientëve.

2.3.4 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të jashtme e të brendshme, objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 28 (njëzet e tetë) punonjës, si më poshtë:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1	Përgjegjës Shërbimi	2 (dy)
2	Punonjës pastrami/sanitar	24 (njëzet e katër)
3	Shofer për drejtimin e mjeteve të kërkuara	2 (dy)
	Totali	28 (njëzet e tetë)

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

**a) Për Përgjegjës të Shërbimit:**

**Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/Ekspert Mjedisi, dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:**

- Diplomë me profesion Inxhinier Mjedisi dhe/ose Certifikatë “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor”;
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;

**b) Për punonjësit e pastrimit/ sanitar, të paraqitet:**

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

**b.1)** Nga numri total i punonjësve të pastrimit/sanitar (24 (njëzet e katër)), 2 (dy) prej tyre duhet të jenë të trajnuar dhe të pajisur me certifikate të punimeve në lartësi të lëshuara nga shoqëri të licensuara nga ministria përkatëse, për të cilët përveç kontratës së punës, duhet të paraqitet edhe dokumentin/certifikatën e trajnimit për punimet në lartësi (të vlefshme).

**c) Për punonjësit shofer, të paraqitet:**

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi në përputhje me mjetet e kërkuara, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari,

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

Përgjegjësi i shërbimit nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e punëve, me qëllim që shërbimi objekt prokurimi të kryhet sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës.

Duke vlerësuar që shërbimi i pastrimit të ambjenteve të brendshme e të jashtme të spitalit, është një shërbim gjatë kryerjes të së cilit kërkohet përdorimi i produkteve që përmbajnë kimikate, përdorimi i produkteve që mund të çojnë në lëshimin e ndotësve të ajrit të brendshëm, të cilat mund të jenë të dëmshme për shëndetin e pacientëve dhe stafit, përdorimi i makinerive të pastrimit, të cilat kontribuojnë në emetimin e gazrave të dëmshëm, vlerësohet që përgjegjësi i shërbimit të jetë inxhinier mjedisi/ekspert mjedisi, i cili do të kryejë mbikëqyrjen e realizimit të shërbimit, objekt prokurimi, konform kushteve dhe standarteve të kërkuara për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në specifikimet teknike.

Punonjësit e pastrimit/sanitar janë të nevojshme për kryerjen e pastrimit, në ambientet e brendshme dhe të jashtme, sipas specifikimeve teknike, grafikut të realizimit, termave të referencës të vendosura nga AK. Bazuar në Ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i ndryshuar, kërkohet që dy nga këto punonjës të jenë të trajnuar për punimet në lartësi, duke qenë se pjesë e shërbimit është edhe pastrimi i dritareve në lartësi, duke krijuar siguri për AK se ofertuesi disponon fuqinë punëtore me kualifikimet e nevojshme.

Duke qenë se për kryerjen e proceseve të shërbimit, objekt prokurimi është fshirja, larja e cila do të bëhet me mjete teknologjike, pastrimi i dritareve në lartësi me vinç me kosh në lartësi, shoferët janë të nevojshëm për drejtimin e këtyre mjeteve.

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhe të përmbushë ky shërbim, i cili sipas specifikimeve teknike është 24 orësh, me tre turne dhe në disa ambjente, të cilat janë vënë në funksion të spitalit dhe të përcaktuara në termat e referencës.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

### 2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Makinë për larjen e sipërfaqeve të jashtme (Autobot)	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
2	Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
3	Vinç me kosh për larjen e dritareve në lartësi	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim

4	Makinë larëse për ambientet e brendshme	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
5	Karroca profesionale (karrela) për shërbimin e pastrimit	Copë	15 (pesëmbëdhjetë)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
6	Kazanë plehrash teknologjike (me mekanizëm)	Copë	6 (gjashtë)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
7	Kosha të vegjël mbeturinash anës rrugëve	Copë	18 (tetëmbëdhjetë)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë (të vlefshëm), si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, operatori ekonomik, duhet të paraqesë dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), ku të identifikohen të dhënat teknike të tyre.

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me të gjitha proceset që duhet të kryejë ofertuesi për realizimin e shërbimit, objekt prokurimi, siç është: larja dhe fshirja e rrugëve, pastrimi i dritareve në lartësi, pastrimi i ambienteve, mbledhja e mbeturinave.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojnë se do të sigurojnë disponimin ose mundësinë e disponimit, me shpenzimet e veta dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara, të pajisjeve, makinerive, materialeve dhe aksesoreve të pastrimit, të cilat nevojiten për përmbushjen e kontratës/ava që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entit kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të

veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe duke iu referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës, me qëllim që AK të krijojë siguri që ofertuesi disponon materialet, detergjentët, aksesorët e pastrimit, makineritë, pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të cilat janë pjesë e pandashme e procesit të shërbimit të pastrimit, objekt prokurimi. Përdorimi i produkteve të pastrimit, të cilat plotësojnë standartet e cilësisë të kërkuara nga AK në specifikimet teknike është shumë i rëndësishëm duke mbajtur në konsideratë vendin ku do të kryhet ku shërbim, që është spital.

2.3.7 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Duke iu referuar natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike dhe termave të referencës, dhe rrezikshmërinë që paraqet ambienti spitalor dhe shërbimi objekt prokurimi në vetvete, është e rëndësishme për AK të krijojë siguri që ofertuesi do të kryejë këtë shërbim, duke garantuar shëndetin dhe sigurinë teknike në punë të punëmarrësve të angazhuar.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

*Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentat e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentat e kërkuar sipas legjislacionit të fushës.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**